

Macomb Endoscopy Center
48801 Romeo Plank Rd. Ste 101
Macomb, MI 48044

Surgical Centers of Michigan
4600 Investment Dr. Ste 270
Troy, MI 48098

Sante D. Bologna, MD, FACP
John R. Weber, MD
Richard T. Wille, MD
Partha S. Nandi, MD, FACP

M. Emin Donat, MD, MRCPC
Leonard G. Quallich III, MD
Anezi Bakken, MD, MS
Amir Abadir, MD, FRCPC

Jack R. Tocco, DO
Ihab Hammoud, MD, FACC

Data e procedurës:



Macomb Endoscopy Center (Qendra Endoskopike e Makombit) dhe Surgical Centers of Michigan (Qendrat Kirurgjike të Miçiganit) Udhëzimet e përgatitjes për kolonoskopi

3 deri në 5 ditë përpara kolonoskopisë	2 ditë përpara kolonoskopisë	1 ditë përpara kolonoskopisë	Dita e kolonoskopisë
<p>Gjeni një shofer të licencuar që do të regjistrohet bashkë me ju, do të qëndrojë në dhomën e pritjes gjatë procedurës suaj dhe do t'ju dërgojë me makinë në shtëpi.</p> <p>Kontaktoni mjekët rekomandues për udhëzime mbi insulinën dhe barnat e diabetit.</p> <p>Mos merrni marihuanë, suplemente hekuri/multivitamina me përmbajtje hekuri.</p> <p>Ndërpritni suplementet e fibrave ("Metamucil", "Citrucel" etj.)</p> <p>Shmangni ushqimet me përmbajtje të lartë fibrash (Për shembuj, shihni "Informacion i rëndësishëm për kolonoskopinë").</p>	<p><u>Nëse vuani nga konstipacioni (kapsllëku)</u> ose keni vështirësi me pastrimin e zorrës së trashë. Ju lutemi referojuni pikave të mëposhtme: Hani një mëngjes të lehtë dhe një drekë me lëngje të papërziera.</p> <p>12:00 – 18:00: Pini një shishe 10 oz (300 ml) me citrat magnezi (nga frigoriferi) brenda disa minutave.</p> <p>Pasi të keni konsumuar citratin e magnezit, pini të paktën tre gota nga 8 oz (240 ml) me lëngje të papërziera. Vazhdoni dietën me lëngje të papërziera gjatë pjesës së mbetur të ditës.</p> <p><u>Lista e produkteve për t'u blerë</u></p> <ul style="list-style-type: none"> • Tableta Dulcolax 5 mg (4 tableta) • MiraLax 238 gm (të ndahet në 2 shishe "Gatorade") • 2-32 oz (60-950 ml) "Gatorade" (vetëm produkte pa ngjyrë, me ngjyrë të verdhë, portokalli ose të gjelbër) • "Fleet Enema" • 10 oz (300 ml) citrat magnezi (Nëse vuani nga konstipacioni ose keni vështirësi me pastrimin e zorrës së trashë) 	<p>Mos konsumoni alkool, ushqime të ngurta ose produkte bulmeti. Shmangni konsumin e produkteve me ngjyrë të kuqe, blu ose vjollcë.</p> <p>Ju lutemi të nisni një dietë me lëngje të papërziera (Për shembuj shihni "Informacion i rëndësishëm për kolonoskopinë").</p> <p>Në ora 3:00 pasdite: Merrni dy tableta "Dulcolax" 5 mg me ujë. Përzieni ½ e "MiraLax" 238 gm në secilën prej dy shisheve "Gatorade" 32 oz (950 ml) derisa të tretet. Ftoheni në frigorifer.</p> <p>Në ora 6:00 pasdite: Pini përzierjen e parë 32 oz (950 ml) të "Gatorade/ MiraLax" duke konsumuar 8 oz (240 ml) çdo 15-20 minuta derisa ta mbaroni.</p> <p>Në ora 8 pasdite: Merrni dy tableta "Dulcolax" 5 mg me 8 oz (240 ml) lëngje të papërziera dhe vazhdoni konsumin e këtyre lëngjeve derisa të flini.</p>	<p>00:00 (mesnatë): Filloni të konsumoni përzierjen e dytë 32 oz (950 ml) "Gatorade/MiraLax". Pini 8 oz (240 ml) nga përzierja çdo 15-20 minuta derisa ta mbaroni.</p> <p>Mos filloni të konsumoni ushqime. Mos pini lëngje (përfshirë ujë) katër orë përpara kohës së mbërritjes, përveç barnave të renditura më poshtë.</p> <p>Mëngjesin e procedurës merrni barnat për konvulsionet, tensionin e gjakut dhe/ose zemrën me deri në 2 oz (60 ml) ujë. MOS merrni barna diuretike (pilula uji).</p> <p>MOS konsumoni çamçakëz, mente ose karamelle të forta deri pas procedurës.</p> <p>*Shikoni pjesën e pasme për listën e barnave, alergjive dhe ndërhyrjeve kirurgjikale. Ju lutemi, plotësojeni dhe merreni me vete ditën e procedurës.</p>



Lista e barnave, alergjive dhe ndërhyrjeve kirurgjikale

Bari	Doza	Shpeshtësia

Alergjia	Reaksioni	Ndërhyrja kirurgjikale



Informacion i rëndësishëm për kolonoskopinë

- ❖ Nuk duhet të hani ose të pini (përfshirë ujë) katër orë përpara kohës së mbërritjes, **përveç** barnave për konvulsionet, tensionin e gjakut dhe/ose zemrën. Mos konsumoni çamçakëz, mente ose karamеле të forta deri pas procedurës. **PROCEDURA JUAJ DO TË ANULOHEË NËSE KONSUMONI USHQIME OSE PIJE.**
- ❖ **Procedura juaj do të anulohet nëse nuk shoqëroheni nga një shofer. Nuk do të mund ta drejtoni automjetin gjatë gjithë ditës së procedurës.**
- ❖ **KUJDES PËR TË GJITHA FEMRAT:** Kur të mbërrini duhet të sillni me vete një kampion urine, me përjashtim të rastit kur keni kryer një histerektomi ose jeni 51 vjeç e lart dhe jeni në menopauzë për një vit.
- ❖ Në ushqimet me përmbajtje të lartë fibrash përfshihen lëkurat e frutave, frutat e freskëta ose të thata, rrushi, domatet, buka e grurit/drithërat, farat, arrat, kokoshkat, bishtajat dhe barbutat.
- ❖ Në dietën me lëngje të papërziera përfshihen lëngjet transparente, si p.sh.: lëngu i mishit ose supa, uji, pijet freskuese ("Vernors", "Sprite"), kasatat, "Propel", xhelatinat, lëngjet e frutave **pa tul** (mollë, rrush i bardhë). Janë të pranueshme edhe pijet e mëposhtme: "Coke/Pepsi", limonada, "Gatorade"/uji me vitamina (përveç produkteve me ngjyrë të kuqe, blu ose vjollcë), kafeja ose çaji – mund të përdoret sheqer/ëmbëlsues, por JO qumësht ose krem/ajkë.
- ❖ Nëse keni shqetësime nga jashtëqitjet e shpeshta, përdorni produkte me bazë vazeline ose krem për acarimin e lëkurës në zonën rektale. Merrni në konsideratë përdorimin e një mbrojtëseje për shtratin.
- ❖ Nëse jashtëqitja e fundit gjatë mëngjesit të kryerjes së kolonoskopisë nuk është e pastër ose nuk ka ngjyrë të verdhë, përdorni një "fleet enema". Përdoreni vetëm nëse nuk keni sëmundje të veshkave dhe nëse jeni nën moshën 70 vjeç.

Ju lutemi, shqyrtoni tabelën e mëposhtme nëse po merrni ndonjë nga barnat e renditura. Nëse keni përdorur këto barna gjatë vitit të fundit, kontaktoni kardiologun tuaj për udhëzime dhe informoni mjekun për çdo ndryshim të bërë.

Aspirinë	Vazhdoni ta përdorni
Aspirinë me "Effient"/prasugrel	Ndërpriteni "Effient" 7 ditë përpara
Aspirinë me "Brilinta"/tikagrelor	Ndërpriteni "Brilinta" 5 ditë përpara
Aspirinë me "Plavix"/klopidogrel	Ndërpriteni "Plavix" 5 ditë përpara
Vetëm "Plavix", "Effient", "Brilinta"	Vazhdoni ta përdorni
"Coumadin"/varfarinë	Ndërpriteni 3 ditë përpara. Nëse keni sëmundje vaskulare